

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magjistratëve, Gjykata e Lartë nuk merr pjesë në tryezën e Ramës! Sadushi: Të flasë më parë K ushtetuesja
ADRESA	https://versus.al/politike/pagat-e-magjistrateve-gjykata-e-larte-nuk-merr-pjese-ne-tryez-en-e-rames-i47237
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 10:56:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 10:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	075ebdd93d99720f8db7bc53913988a90fc2ada088815be8d499eabe324edb24
TEKSTI	6ff5e89910ddc0091ebb734a7f8072fe2c5274ee702612fad2ff39c4d116d0a8
PAMJA	50ad1dbdfce0a0f123cd818812111707e7f25db11034986f10c32f66a3b74ca4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86851365c1e6747ac3343fd77f07bd72eb7179ea88edb8908b81ff25a3ffa438
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdf5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/86851365c1e6747ac3343fd77f07bd72eb7179ea88edb8908b81ff25a3ffa438

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Kokainë e heroinë pranë shkollave në Tiranë, droga shpërndahej me taksi e monopatina! Zbulohet roli i ish-policit në grupet e shpërndarjes!](#)

27 Shtator 2026, 11:34

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[POLITIKË](#) / 27 Shtator 2026, 12:40

Pagat e magistratëve, Gjykata e Lartë nuk merr pjesë në tryezën e Ramës! Sadushi: Të flasë më parë Kushtetuesja

Sadushi thekson se ky qëndrim nuk është refuzim i dialogut mes pushteteve.





Gjykata e Lartë nuk do të përfaqësohet në tryezën e thirrur për të hënën, më 28 shtator, nga kryeministri Edi Rama për pagat e magistratëve.

Në përgjigjen dërguar Kryeministrit, kreu i saj, Sokol Sadushi, shpjegon se ligji i ri për pagat është çuar për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese dhe se dialogu për të njëjtën çështje do të ishte më i dobishëm pasi ajo të shprehet.

Sadushi thekson se ky qëndrim nuk është refuzim i dialogut mes pushteteve.

Ai propozon një tryezë më të gjerë për funksionimin e sistemit të drejtësisë, me fokus problemet që ndikojnë në cilësinë dhe kohën e dhënies së drejtësisë.

Të njëjtën nevojë për një agjendë më të gjerë ai e kishte ngritur edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve.

Qëndrimi vjen pas miratimit në Kuvend, më 18 shtator, të formulës së re të pagave të magistratëve me 84 vota.

Formula është kundërshtuar nga shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Përgjigjja e plotë e Sokol Sadushit, dërguar Kryeministrit më 26 shtator 2026:

Mirëmëngjes,

Në vijim të komunikimit tuaj të djeshëm për konfirmimin e pjesëmarrjes në takimin e datës 28 shtator, dëshiroj të rikujtoj qëndrimin e mbajtur në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve.

Besoj të dialogu ndërmjet pushteteve dhe mbetem i hapur ndaj tij. Megjithatë, pas ftesës së datës 18 shtator ka ndodhur një zhvillim institucional që nuk ekzistonte në atë moment dhe që lidhet drejtpërdrejt me objektin e tryezës. Ligji i ri për pagat i është nënshtruar kontrollit të Gjykatës Kushtetuese.

Kjo rrethanë e re ndikon, në vlerësimin tim, si në kohën, ashtu edhe në përmbajtjen e dialogut. Për një çështje kushtetuese tashmë të shtruar për gjykim, fjala i përket Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, dialogu për këtë objekt mund të jetë substancial dhe efektiv pasi ajo të jetë shprehur.

Në këto kushte, pjesëmarrja në një tryezë me të njëjtin objekt, vetëm për të përsëritur qëndrimin institucional të shprehur publikisht, nuk do t'i shtonte dialogut një përmbajtje të re. Dialogu ka vlerë kur ekziston hapësira institucionale që prej tij të prodhohet diçka më shumë sesa ritheximi i qëndrimeve të bëra të qarta.

Kjo nuk e mbyll hapësirën e dialogut institucional. Sikurse kam theksuar, drejtësia ka nevojë për një tryezë me një dimension më të gjerë, kushtuar funksionimit dhe konsolidimit të sistemit dhe problemeve që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe kohën e dhënies së drejtësisë.

Për hapjen e këtij dialogu, gatishmëria ime dhe e institucionit që përfaqësoj mbetet e plotë. Është një dialog i nevojshëm dhe tashmë i vonuar.

Do ta mirëprisja zhvillimin sa më parë të një tryeze me këtë temë dhe me këtë dimension: një dialog ndërmjet pushteteve, me qytetarin në qendër.

Me konsideratë,

Sokol Sadushi
Kryetar i Gjykatës së Lartë

Tags:

[sokol sadushi](#)

Poll






POLITIKË

[VIDEO/ Rinasi “blindohet” para mbërritjes së Ramës, kryeministri pritet t’u drejtohet qytetarëve](#)

27 Shtator 2026, 12:46

^ekstrakti^




POLITIKË

[Skandali me ish-shefen e SHISH/ Rama pritet të flasë sot nga Rinasi pas kthimit nga SHBA! Nesër mbledhet Këshilli i Sigurimit Kombëtar](#)

27 Shtator 2026, 08:47

^ekstrakti^



POLITIKË

[Skandali me ish-shefen e SHISH/ Rama mesazh shqiptarëve nga Rinasi pas kthimit nga SHBA](#)

26 Shtator 2026, 21:38

^ekstrakti^




POLITIKË

[“Zvërneci dhe Sazani, projekte të jashtëzakonshme”, Rama: Po studiojmë rrisqet reale në mjedis, jo ato që prodhohen në rrjete sociale](#)

26 Shtator 2026, 21:26

^ekstrakti^



POLITIKË

[“Keni dëgjuar se Paketa e Maleve është bërë për të vjedhur”, Rama në SHBA fton shqiptarët të investojnë: Është për të gjithë ju!](#)

26 Shtator 2026, 21:10

^ekstrakti^



POLITIKË

[FOTO-LAJM/ Rama me shqiptarët në Staten Island, pritët me tortën me "flamingot"](#)

26 Shtator 2026, 20:43

^ekstrakti^



POLITIKË

[“Një nga ata që hodhën vezë kishte ardhur nga Anglia, shpresoj të ketë kaluar mirë me policinë e Nju Jorkut”, Rama në SHBA: Mu duk vetja si në Tiranë!](#)

26 Shtator 2026, 20:30

^ekstrakti^



POLITIKË

“Kuvendi nuk zbaton vendimin e GJK”, PD i kërkon Peleshit ngritjen e Komisionit Hetimor për zgjedhjet e 11 majit

26 Shtator 2026, 17:08

^ekstrakti^

Të fundit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.